



**JAHJAGA**

FOUNDATION

Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica

Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative  
Uprava za Opšte, Administrativne Poskove



Nr./Br. 01 413/21-25938

Data/Datum 14.11.2022

Gjakovë-Djakovica-Gjakova



## **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

në mes të

### **Fondacionit Jahjaga**

*Rr. Agim Ramadani H.32, nr. 10,*

*10000 Prishtinë, Kosovë*

dhe

### **Komunës së Gjakovës**

*Rr. Nëna Tereze, 50000 Gjakovë*

## **Sfondi**

Fondacioni Jahjaga përmes programit të grave në politikë, në vazhdimësi kontribon në promovimin dhe fuqizimin e rolit të gruas në politikë. Nën këtë program gjithashtu një fokus i veçantë i kushtohet rinisë, me theks inkurajimit dhe fuqizimit të vajzave të reja të cilat kanë aspirata të zhvillimit të karrierës në politikë.

Në këtë linjë Fondacioni Jahjaga në kuadër të projektit *"Diversiteti gjinor si mjet për politika dhe programe gjithëpërfshirëse në nivel lokal"*, i cili mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim është duke organizuar programin *"Zhvillimi i njohurive mbi qeverisjen lokale"*, në kuadër të të cilit 38 vajza të reja (studente dhe të sapo-diplomuara) po zhvillojnë aftësitë e tyre në fushën e qeverisjes lokale, përmes tri fazave të programit: pjesës teorike, trajnimeve dhe fazës së mentorimit.

Përmes këtij bashkëpunimi, synojmë që të fuqizojmë/përgatisim vajzat e reja me njohuri mbi qeverisjen lokale duke iu ofruar mundësi mentorimi nga drejtoresha komunale apo gra në pozita tjera udhëheqëse të qeverisjes lokale.

## **Neni 1**

### **Qëllimi i marrëveshjes**

Përmes kësaj marrëveshjeje synohet krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit mes Fondacionit Jahjaga dhe Komunës së Gjakovës në ofrimin e mundësive dhe hapësirave për realizimin e fazës së mentorimit në bashkëpunim me drejtoreshat komunale. Më konkretisht, përgjatë një muaji 4 vajza do të kenë mundësinë të punojnë dhe mësojnë nga 3 drejtoresha të Komunës së Gjakovës.

## **Neni 2**

### **Periudha dhe kohëzgjatja e fazës së mentorimit**

Në tërësi faza e mentorimit do të zgjasë katër javë; dy javët e para do të zhvillohen prej **05 – 16 dhjetor 2022**, pastaj dy javët tjera do të vazhdojnë pas festave, prej **17 – 27 janar 2023**. Do të thotë brenda kësaj periudhe vajzat do të jenë në Komunë ku do të punojnë dhe mësojnë nga mentoret e përcaktuara/drejtoreshat komunale.

## **Neni 3**

### **Mënyra e realizimit të marrëveshjes së bashkëpunimit**

Palët nënshkruese pajtohen të bashkëpunojnë në realizimin e veprimeve në vijim, në mënyrë që të përmbushin qëllimin e marrëveshjes së bashkëpunimit.

#### **2.1. Përgjegjësitë e Fondacionit Jahjaga**

- Fondacioni Jahjaga është përgjegjës për përzgjedhjen e vajzave që do të përfitojnë nga mentorimi prej drejtoreshave të Komunës së Gjakovës;
- Fondacioni Jahjaga gjithashtu do të bëjë kontaktimin dhe koordinimin me drejtoreshat komunale dhe gratë tjera në pozita udhëheqëse të cilat do të kenë rolin e mentoreve në programin “Zhvillimi i njohurive mbi qeverisjen lokale”;
- Para fillimit të fazës së mentorimit, Fondacioni Jahjaga do të koordinoj takimin njoftues mes grave dhe vajzave që do të punojnë së bashku përgjatë periudhës së mentorimit;

- Fondacioni Jahjaga do të mbajë kontakt të vazhdueshëm me gratë dhe vajzat përgjatë periudhës së mentorimit, për të përcjellur përvojën dhe vijueshmërinë e procesit;
- Fondacioni Jahjaga gjithashtu do të kujdeset për të asistuar si vajzat ashtu edhe gratë gjatë fazës së mentorimit nëse është e nevojshme;

## **2.2. Përgjegjësitë e Komunës së Gjakovës**

- Komuna e Gjakovës përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit do të autorizoj drejtoreshat komunale dhe gratë tjera në pozita udhëheqëse të cilat janë përzgjedhur si mentore në kuadër të programit *"Zhvillimi i njohurive mbi qeverisjen lokale"* për të pranuar vajzat në drejtoritë përkatëse;
- Komuna e Gjakovës do të ofroj bashkëpunimin e departamenteve dhe njësive të ndryshme nëse një gjë e tillë kërkohet nga mentorët në mënyrë që vajzat të kenë një përvojë më të gjerë në funksionimin e komunës;
- Komuna e Gjakovës është përgjegjëse për ofrimin e një hapësire pune për këto vajza përgjatë fazës së mentorimit;
- Komuna e Gjakovës mund të shprehë interesimin për vazhdimin e mentorimit dhe/ose kontraktimit të vajzave për praktikë apo punë sipas nevojës

## **Neni 4**

### **Koordinimi mes palëve**

Koordinimi dhe konsultimi në mes të palëve nënshkruese do të bëhet përmes Menaxherës së Projektit *"Diversiteti gjinor si mjet për politika dhe programe gjithëpërfshirëse në nivel lokal"* dhe znj. Nita Efendia Brovina, Shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës.

Palët pajtohen të takohen sipas nevojës, për të diskutuar zhvillimin dhe avancimin e

marrëveshjes, për të raportuar lidhur me përgjegjësitë përkatëse që dalin nga kjo marrëveshje, për të identifikuar pengesat që mund të ndikojnë realizimin e kësaj marrëveshje si dhe për t'u dakorduar në mënyrat e adresimit të secilit problem eventual.

### **Neni 5**

#### **Konfidencialiteti**

Palët nënshkruese janë të obliguara të ruajnë konfidencialitetin e informatave të ndara në mes njëri-tjetrit.

### **Neni 6**

#### **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka afat prej datës së nënshkrimit deri më 15 Shkurt 2023.

### **Neni 7**

#### **Ndryshimi i marrëveshjes**

Modifikimi i marrëveshjes duhet të bëhet me kërkesë me shkrim dhe në rast të aprovimit me shkrim nga palët, kjo marrëveshje bashkëpunimi duhet të amandamentohet dhe të nënshkruhet nga palët bashkëpunuese.

Prishtinë, Republika e Kosovës

Tetor, 2022

**Fondacioni Jahjaga**

Brikena Avdyli,

Drejtoreshë Ekzekutive



**Komuna e Gjakovës**

Ardian Gjini,

Kryetar i Komunës

